



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M  
K.P.P. 272/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.05.2018 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

**Objekt:**

Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “SEAD – SGS” sh.p.k. nga procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-53685-03-05-2018, me objekt: “Blerje ushqime për Spitalin Rajonal Shkodër për vitin 2018”, me fond limit 7.009.992 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 16.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Shkodër.

Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e bashkimi të operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “MB Kurti” sh.p.k. nga procedura e mësipërme e prokurimit.

**Ankimues:**

“SEAD – SGS” sh.p.k.  
Lagja “Kashar 2”, Rruga “Mullishter”, godinë 1-katëshe, Nr.  
Pasurie 4, Zona kadastrale 2105, Kashar – Tiranë

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “MB Kurti” sh.p.k.  
Rruga “Bulevardi Skënderbeg”, pas Kinema Millenium, Shkodër

**Autoriteti Kontraktor:**

Spitali Rajonal Shkodër  
Lagja “Skënderbeg”, Shkodër

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 06.03.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-53685-03-05-2018, me objekt: “Blerje ushqime për Spitalin Rajonal Shkodër për vitin 2018”, me fond limit 7.009.992 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 16.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Shkodër.

II.2. Në datën 16.03.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. BO “Nika” sh.p.k. & “MB Kurti” sh.p.k. 6.850.400 lekë, skualifikuar
2. “SEAD-SGS” sh.p.k. 6.921.240 lekë, skualifikuar

II.3. Në datën 20.03.2018 operatori ekonomik “SEAD-SGS” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Mungesë e kopjeve të certifikuar të bilaceve për vitin 2014, 2015.*
- *Mungesë e xhiros për vitin 2015.*
- *Mungesë e lejes së transportit nga Komuna apo Bashkia për vete ose të tjeret.*

II.3.1. Në datën 23.03.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij. Konkretisht në ankesë pretendohet si më poshtë vijon:

[...]

*Së pari, jemi skualifikuar me pretendimin se nuk kemi paraqitur bilancet për vitet 2014, 2015 si dhe xhiron e vitit 2015. Në lidhje me këtë pikë ju sqarojmë se “SEAD SGS” sh.p.k. është regjistruar në regjistrin tregëtar shqiptar më datë 25.05.2016. Nisur nga ky fakt, ne nuk kemi patur se si të paraqesim bilancet për vitet 2014 – 2015 në një kohë që nuk kemi ekzistuar si shoqëri, pra ne nuk kemi ushtruar aktivitetet për këto vite. E njëjta gjë vlen edhe për xhiron e vitit 2015 dokument i cili nuk mund të lëshohet për shoqërinë tonë pasi ne nuk kemi ushtruar aktivitetet për këtë vit. Në përmbushje të kriterit të vendosur nga ana juaj në DST që xhiroja mesatare vjetore për vitet 2015-2016-2017) të jetë më një vlerë prej 40% të fondit limit, ne kemi paraqitur xhiron e viteve 2016-2017 në një vlerë shumë herë më të lartë se vlera e kërkuar nga ju në DST, pra duke e përmbushur më së miri këtë pikë. Në lidhje me këtë pikë është shprehur edhe KPP me vendimin 633/2017, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve ku i jep të drejtë shoqërisë tonë.*

*Së dyti jemi skualifikuar me pretendimin se nuk kemi paraqitur lejen e transportit nga Komuna apo Bashkia për vete ose të tjerët. Në lidhje me këtë pikë ju sqarojmë se mjetet e paraqitura nga ana jonë janë të pajisur me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor. Mungesa e lejes së transportit për këto automjete justifikohet me faktin se këto automjete kanë një kapacitet mbartës nën 1.5 ton dhe si të tillë në bazë të ligjit nr. 8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” neni 46, Udhëzimit nr. 15. Datë 24.07.2007, neni 28 këto automjete nuk mund të certifikohen për transport mallrash brenda vendit. Gjithashtu në mbështetje të këtij fakti ne si shoqëri kemi aplikuar pranë zyrave të Bashkisë Shkodër për tu pajisur me leje transporti dhe përgjigja e tyre ka qenë se këto automjete me ngarkesë nën 1500 kg nuk certifikohen. Bashkëlidhur formularit të ankesës keni edhe përgjigjen e dhënë nga Bashkia Shkodër. Për sa më lart skualifikimi i shoqërisë tonë nga procedura e prokurimit është në kundërshtim me dispozitat ligjore të mësipërme.*

II.3.2. Në datën 29.03.2018, nëpërmjet shkresës me nr. 1114 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar ankesën e paraqitur.

II.3.3. Në datën 03.04.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat si në autoritetin kontraktor.

II.4. Në datën 20.03.2018 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “MB Kurti” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsye si më poshtë vijon:

- *Mungesë e vërtetimit të regjistrimit pranë AKU. Ekziston vetëm një vërtetim ispektimi për magazinë ushqimore të vitit 2017.*
- *Mungesë e një specialist veteriner në listpagesat për 6 mujorin e fundit ,shoqëruar me kontratë të rregullt pune CV dhe diplomë.*

II.4.1. Në datën 26.03.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij. Konkretisht në ankesë pretendohet si më poshtë vijon:

[...]

*Vendimi është absolutisht i padrejtë dhe i bazuar në pretendime hipotetike dhe jo në fakte që ekzistojnë. Nga ana jonë janë plotësuar në mënyrë të përpiktë të gjitha dokumentat tekniko-ligjor. Së pari në lidhje me pretendimin se nuk kemi paraqitur vërtetimin për vitin 2018, sqarojmë se vërtetimi i AKU i kërkuar nga ana juaj nuk është specifikuar që të jetë i vitit 2018. Ne kemi paraqitur vërtetimin përkatës të lëshuar nga AKU konform të gjitha dispozitave ligjore dhe provon qartësisht faktin se ne jemi të regjistruar në AKU, ushtrojmë aktivitet në mënyrë të rregullt dhe i plotësojmë të gjitha kushtet ligjore të vendosura nga ky institucion. Edhe në bazë të ekstraktit të QKB nuk rezulton që ne nga viti 2017 e deri aktualisht të kemi ndërprerë aktivitetin tonë. Së dyti në lidhje me pretendimin se mungon veterineri, sqarojmë se nga ana jonë janë paraqitur disa specialiste ekuivalent të cilin realizojnë të njëjtin shërbim, duke provuar se cilësia e produkteve ushqimore të gatshme për të dorëzuar pranë jush, janë në përputhje të plotë me normat dhe standartet e vendosura nga institucionet e sigurisë ushqimore dhe njëkohësisht në përputhje me specifikimet teknike të vendosura nga ana juaj. Qëllimi që ka AK në vendosjen e kriterëve të pjesmarrjes në tender është që të krijohet besueshmëria e plotë se realizimi i kontratës do të jetë i sukseshëm dhe nuk do të ketë problem në realizimin e furnizimeve me produkte ushqimore. Me specialistat që kemi në gjendje dhe disponibël për tu vënë në shërbim të realizimit të shërbimit, plotësohet në mënyrë rigoroze qëllimi i shërbimit të kërkuar nga ana juaj. Bashkëngjitur pretendimeve tona po ju dërgojmë edhe dokumentacionin e duhur për të provuar disponibilitetin e specialistave për realizimin e kësaj kontrate. Edhe përcaktimi ligjor për rastet e kriterëve specifikimeve nënkupton faktin se për të provuar përmbushjen e kriterëve ligjore mund të paraqiten dokumenta apo element të tjerë provues që vërtetojnë faktin se operatori ekonomik e plotëson një kriter të tillë. Aq më tepër një gjë të tillë e vërteton edhe fakti se duke qenë se nga ana juaj është kërkuar thertore, ligjërisht çdo kafshë që theret në një thertore të licensuar (që e kemi paraqitur) mbikëqyret nga veterineri i bashkisë apo specialisti ekuivalent. Sqarojmë se me këtë vendimarrje të kundraligjshme dhe jo të padrejtë i shkaktohet një dëm relativisht i madh buxhetit të institucionit tuaj dhe taksave të shtetasve shqiptar. Sa më sipër kërkojmë nga ana juaj të rishikohet vendimi i komisionit të vlerësimit të ofertave, të kualifikohet dhe të shpallet fituese shoqëria Nika sh.p.k.*

II.4.2. Në datën 29.03.2018, nëpërmjet shkresës me nr. 1113 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, duke e refuzuar ankesën e paraqitur. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues pretendon se ka marrë për kthim përgjigjen nga autoriteti kontraktor në datë 30.03.2018.

II.4.3. Në datën 06.04.2018 Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat si në autoritetin kontraktor.

II.5. Nëpërmjet shkresës me nr. 1229 prot., datë 06.04.2018, të protokolluar me tonën në datën 10.04.2018 dhe shkresës me nr. 1320 prot., datë 13.04.2018, të protokolluar me tonën në datën 18.04.2018, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “SEAD-SGS” sh.p.k mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se “[...] jemi skualifikuar me pretendimin se nuk kemi paraqitur bilancet për vitet 2014, 2015 si dhe xhiron e vitit 2015. Në lidhje me këtë pikë ju sqarojmë se “SEAD SGS” sh.p.k. është regjistruar në regjistrin tregëtar shqiptar më datë 25.05.2016. Nisur nga ky fakt, ne nuk kemi patur se si të paraqesim bilancet për vitet 2014 – 2015 në një kohë që nuk kemi ekzistuar si shoqëri, pra ne nuk kemi ushtruar aktivitetet për këto vite. E njëjta gjë vlen edhe për xhiron e vitit 2015 dokument i cili nuk mund të lëshohet për shoqërinë tonë pasi ne nuk kemi ushtruar aktivitetet për këtë vit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” pika 2.2 “Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

A) Kopje të certifikuara të bilancit të vitit 2014-2015- 2016 të paraqitura dhe lëshuara nga Drejtoria e Tatim-Taksa.

B) Vërtetim lëshuar nga dega e tatim taksave për xhiron mesatare vjetore të tre viteve të fundit (2015-2016-2017) me një vlerë prej 40 % të fondit limit.

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar :

- *Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar*
- *Shkresën Nr.2297/2 prot., datë 02.02.2018 me objekt “Konfirmim i Pasqyrave Financiare”, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (bashkëlidhur kësaj shkresë janë Pasqyrat Financiare për vitin 2016).*
- *Vërtetim Nr.2297/1 Prot datë 02.02.2018 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane me anë të së cilës vërtetohet se: Tatimpaguesi “SEAD-SGS” [...].....në bazë të të dhënave të situatës financiare të paraqitur për vitet e mëposhtme ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave/shërbimeve si më poshtë:*
  1. *Viti 2016*    *5 583 887 lekë*
  2. *Viti 2017*    *33.669.255 lekë*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “c” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevoje, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur. [...]”

Në nenin 27 “Kontrata e Mallrave” pika 5 gërma “a” dhe “b” e VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

a) *kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse:dhe/ose*

b) *kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet; [...]*”

III.1.4. Referuar ekstraktit të regjistrimit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit rezulton se, operatori ekonomik “SEAD-SGS” sh.p.k është regjistruar në regjistrin tregëtar shqiptar në datën 25.05.2016. Nisur nga kjo, operatori ekonomik “SEAD-SGS” sh.p.k. nuk ka paraqitur bilancet për vitet 2014, 2015, për shkak të mosekzistencës së tij dhe rrjedhimisht mos ushtrimit të aktivitetit në këtë periudhë të vitit.

III.1.5. Gjithashtu në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor për paraqitjen e vërtetimit për xhiron mesatare të tre viteve të fundit (2015, 2016, 2017), operatori ekonomik ankimes ka paraqitur xhiron mesatare për vitet 2016 dhe 2017. Rrjedhimisht në përllogaritje të mesatares, xhiroja e vitit 2015 do të konsiderohet në shifrën 0 (zero) lekë, për shkak se shoqëria nuk ka ushtruar aktivitet gjatë kësaj periudhe. Sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm të paraqitur nga operatori ekonomik “SEAD-SGS” sh.p.k. rezulton se xhiro në vlerë mesatare për vitin 2016 është 5.583.887 lekë dhe për vitin 2017 është 33.669.255 lekë, vlera këto më të mëdha se vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, bazuar në dokumentacionin e paraqitur (si mësipër analizuar), kriteri për xhiron, përmbushet në vlerë nga operatori ekonomik ankimues, për tre vitet e fundit financiare në përputhje me parashikimet ligjore të sipërcituara. Gjithashtu edhe sa i takon bilanceve operatori ekonomik ankimues në pamundësi për të paraqitur bilancet për vitet 2014 dhe 2015 ka paraqitur bilancet për vitin 2016 vit në të cilin është krijuar si person juridik. Komisioni vlerëson se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se *“jemi skualifikuar me pretendimin se nuk kemi paraqitur lejen e transportit nga Komuna apo Bashkia për vete ose të tjerët. Në lidhje me këtë pikë ju sqarojmë se mjetet e paraqitura nga ana jonë janë të pajisur me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor. Mungesa e lejes së transportit për këto automjete justifikohet me faktin se këto automjete kanë një kapacitet mbartës nën 1.5 ton dhe si të tillë në bazë të ligjit nr. 8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” neni 46, Udhëzimit nr. 15. Datë 24.07.2007, neni 28 këto automjete nuk mund të certifikohen për transport mallrash brenda vendit. Gjithashtu në mbështetje të këtij fakti ne si shoqëri kemi aplikuar pranë zyrave të Bashkisë Shkodër për tu pajisur me leje transporti dhe përgjigja e tyre ka qenë se këto automjete me ngarkesë nën 1500 kg nuk certifikohen. Bashkëlidhur formularit të ankesës keni edhe përgjigjen e dhënë nga Bashkia Shkodër”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”*, pika 2.2 *“Kapaciteti Teknik”*, pika 14, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

*14. Operatori ekonomik pjesmarrës në tenderrin e mësipërm duhet të disponoje 2 (dy) mjete të përshtatshëm për transportin e produkteve objekt prokurimi ku njeri prej tyre duhet të jetë frigoriferik të cilët duhet të jenë të pajisur me leje higjieno-sanitare. Mjete duhet të jenë të pajisur me (leje qarkullim), akt kolaudimi, policën e sigurimit të mjetit, taksën si dhe lejen e transportit nga komuna apo bashkia për vete ose të tretët.*

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues, në lidhje me kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor për mjetet, rezulton se është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

[...]

1. *Kontratë qiraje e lidhur në datën 01.06.2016, ndërmjet shoqërisë “LICI” sh.p.k. në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “SEAD-SGS” sh.p.k. në cilësinë e qiramarrësit, me afat 5 vjeçar nga data 01.06.2016 deri më datën 01.06.2021, për mjetet:*

- ATV Mercedes Benz frigorifer, me targa SH XXXX E, i bardhë, nr shasie: WDBXXXXXXXXX [...];
- ATV Ford Transit frigorifer, me targa SH XXXX D, i bardhë, nr shasie: SFALXXXXXXXXX [...];

2. Leje e qarkullimit të mjetit me targë SH XXXX E; Çertifikata e kontrollit të teknik të këtij mjeti; Policë për sigurimin e detyrueshëm të këtij mjetit; Leje Higjeno Sanitare, Nr.11, datë 17.02.2017.
3. Leje e qarkullimit të mjetit me targë SH XXXX D; Çertifikata e kontrollit të teknik të këtij mjeti; Policë për sigurimin e detyrueshëm të këtij mjetit; Leje Higjeno Sanitare, Nr.15, datë 17.02.2017.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.2.4. Në nenin 28, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. [...]

III.2.5. Në nenin 46, Kreu II i Ligjit Nr.8308, datë 18.03.1998, “Për transportet Rrugore”, i ndryshuar, ligjvënësi ka parashikuar:

*Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për mjetet me kapacitet transportues nën 1500 kg.*

III.2.6. Udhëzimi nr. 15, datë 24.07.2007, “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, Neni 6 “Autoriteti kompetent për lëshimin e licencës\autorizimit\certifikatës”, pika 3, parashikon:

*Transporti i mallrave brenda vendit: Lloji i veprimtarisë Dokumenti që lëshohet Autoriteti kompetent. Transporti për të tretë dhe me qira Licencë Bashkia/qarku, për komunat.[...]*

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike,



reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.2.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues për dy mjete e paraqitura, referuar dokumentit leje e qarkullimit të mjetit, në të cilin konstatohen të gjitha të dhënat në lidhje me parametrat e mjetit, ndërmjet të cilave edhe kapaciteti mbajtës i mjetit, evidentohet si më poshtë:

- Për mjetin *ATV Mercedes Benz frigorifer, me targa SH XXXX E*, në dokumentin Leje Qarkullimi, në pjesën *Përmbajtja*, në nr. Rendor 23 dhe 24 janë përkatësisht: Masa maksimale e autorizuar (kg) dhe Masa e mjetit bosh (kg).

Në po këtë dokument, në pjesën *Të dhëna mbi identifikimin e mjetit, Karakteristikat Teknike* evidentohet se në pikat respektive 23 dhe 24 janë të dhënat përkatësisht: 3500 dhe 2200. Nga verifikimi i të dhënave të evidentuara në këtë dokument në pikat 23 dhe 24 të saj, rezulton se kapaciteti mbajtës i këtij mjeti është më pak se 1500 kg.

- Për mjetin *ATV Ford Transit frigorifer, me targa SH XXXX D*, në dokumentin Leje Qarkullimi, në pjesën *Përmbajtja*, në nr. Rendor 23 dhe 24 janë përkatësisht: Masa maksimale e autorizuar (kg) dhe Masa e mjetit bosh (kg).

Në po këtë dokument, në pjesën *Të dhëna mbi identifikimin e mjetit, Karakteristikat Teknike* evidentohet se në pikat respektive 23 dhe 24 janë të dhënat përkatësisht: 3500 dhe 2200 kg. Nga verifikimi i të dhënave të evidentuara në këtë dokument në pikat 23 dhe 24 të saj, rezulton se kapaciteti mbajtës i këtij mjeti është më pak se 1500 kg.

III.2.9. Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, operatori ekonomik ankimues ka përmbush kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit pasi ka paraqitur dy mjete e kërkuara nga autoriteti kontraktor, së bashku me dokumentacionin përkatës sipas kërkesave në dokumentat të tenderit. Për sa i përket arsyes së skualifikimit se operatori ekonomik ankimues nuk ka paraqitur lejen e transportit nga Komuna apo Bashkia, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues për këto mjete, në dokumentin Leje Qarkullimi, në pjesën *Përmbajtja*, në nr. Rendor 23 dhe 24 janë përkatësisht: Masa maksimale e autorizuar (kg) dhe Masa e mjetit bosh (kg). Në po këtë dokument, në pjesën: *Të dhëna mbi identifikimin e mjetit, Karakteristikat Teknike* evidentohet se në pikat respektive 23 dhe 24 janë të dhënat përkatësisht: 3500 dhe 2200 kg. Nga verifikimi i të dhënave të evidentuara në këtë dokument në pikat 23 dhe 24 të saj, rezulton se kapaciteti mbajtës për secilin mjet të paraqitur nga operatori ekonomik “SEAD-SGS” është më pak se 1500 kg. Referuar dispozitave ligjore të lex specialis, konkretisht Ligjit Nr.8308, datë 18.03.1998, “Për transportet Rrugore”, i ndryshuar, ligjvënësi ka parashikuar se këto dispozita nuk zbatohen për mjete me kapacitet transportues nën 1500 kg.

III.2.10. Sa më sipër argumentuar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për sa kohë të dy mjete e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues kanë një kapacitet transportues më të ulët se 1500 kg, atëherë referuar dispozitave ligjore të cilat rregullojnë fushën objekt prokurimi, këto mjete me këtë kapacitet nuk janë objekt certifikimi nga Bashkia përkatëse, kështu që rrjedhimisht operatori ekonomik ankimues nuk mund të paraqesë lejen e transportit nga bashkia për këto mjete, për sa kohë sipas legjislacionit nuk pajiset me këtë leje.

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “SEAD SGS” sh.p.k. ka përmbushur kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Nika” sh.p.k. & “MB Kurti” sh.p.k. për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike me argumentin se “[...]në lidhje me pretendimin se mungon veterineri, sqarojmë se nga ana jonë janë paraqitur disa specialistë ekuivalent të cilin realizojnë të njëjtin shërbim, duke provuar se cilësia e produkteve ushqimore të gatshme për të dorëzuar pranë jush, janë në përputhje të plotë me normat dhe standartet e vendosura nga institucionet e sigurisë ushqimore dhe njëkohësisht në përputhje me specifikimet teknike të vendosura nga ana juaj [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.2 “Kapaciteti Teknik”, pika 12, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

“12. Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në listpagesa për gjashtëmuorin e fundit një specialist veterinar, dhe specialist teknolog të vërtetuara kjo me kontrata të rregullta pune, CV, Diplomë.

III.3.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues rezulton se është paraqitur dokumenti “Akt marrëveshje për bashkimin e përkohëshëm të shoqërive “Nika” sh.p.k. dhe “MB Kurti” sh.p.k., Nr.1906Rep, Nr.697Kol, datë 15.03.2018, sipas së cilës është përcaktuar pjesëmarrja e palëve në grup sipas këtyre raporteve: Shoqëria “Nika” sh.p.k. 60.3 %; Shoqëria “MB Kurti” sh.p.k. 39.7 %.

Gjithashtu, rezulton se është paraqitur dokumenti *Prokurë e Posaçme*, sipas së cilës deklarohet se përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve është shoqëria “Nika” sh.p.k.

III.3.3. Për plotësimin e kriterit të mësipërm, bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur në Sistemin e Prokurimeve Elektronike ( S.P.E.) dokumentacionin e mëposhtëm:

Operatori ekonomik “Nika” sh.p.k.

- Listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi për vitin 2017
- Kontrate Individuale e Punës, datë 01.06.2016 ndërmjet punëdhënësit “Nika” sh.p.k. dhe punëmarrësit Z. A.A, me profesion Kimist-Teknolog Ushqimore; Diplomë Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore; Certifikatë Notash; Letërnjoftim; Librezë Pune.
- Kontrate Individuale e Punës, datë 05.01.2016 ndërmjet punëdhënësit “Nika” sh.p.k. dhe punëmarrësit Znj. E.S, me profesion Kimiste-Teknologe Ushqimore; Diplomë e nivelit të dytë në Kimis Ushqimor; CV; Librezë Pune.
- Kontrate Individuale e Punës, datë 05.10.2016 ndërmjet punëdhënësit “Nika” sh.p.k. dhe punëmarrësit Znj. M.R, me profesion Kuzhinier; 3 Certifikata; Librezë Pune.
- Kontrate Individuale e Punës, datë 26.01.2017 ndërmjet punëdhënësit “Nika” sh.p.k. dhe punëmarrësit Z. A.H, me profesion Kuzhinier; Certifikate; Librezë Pune.

Operatori ekonomik “MB Kurti” sh.p.k.

- Listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi për vitin 2017
- Kontrate Individuale e Punës, datë 31.12.2016 ndërmjet punëdhënësit “MB Kurti” sh.p.k. dhe punëmarrësit Z. K.B, me profesion Inxhinier Teknolog për Ushqime dhe Pije Alkolike (Drejtues Teknik); Diplomë në Kimist Ushqimor; CV; Letërnjoftim; Librezë Shëndetësore; Librezë Pune.

III.3.4. Në Kreun VII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.

Në Kreun VII, pika 2 po këtu, parashikohet: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës.

Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”

ndërsa në pikën 3 parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.3.5. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata; b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.3.6. Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

III.3.7. Sqarojmë se, referuar bazës ligjore si më sipër cituar si edhe kontratës së bashkëpunimit, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e punëve të marra përsipër.

III.3.8. KPP sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të

përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.9. Operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij pretendon se: *Në lidhje me pretendimin se mungon veterineri, sqarojmë se nga ana jonë janë paraqitur disa specialistë ekuivalent të cilin realizojnë të njëjtin shërbim, duke provuar se cilësia e produkteve ushqimore të gatshme për të dorëzuar pranë jush, janë në përputhje të plotë me normat dhe standartet e vendosura nga institucionet e sigurisë ushqimore dhe njëkohësisht në përputhje me specifikimet teknike të vendosura nga ana juaj. Qëllimi që ka AK në vendosjen e kriterëve të pjesmarrjes në tender është që të krijohet besueshmëria e plotë se realizimi i kontratës do të jetë i sukseshëm dhe nuk do të ketë problem në realizimin e furnizimeve me produkte ushqimore. Me specialistat që kemi në gjendje dhe disponibël për tu vënë në shërbim të realizimit të shërbimit, plotësohet në mënyrë rigorozë qëllimi i shërbimit të kërkuar nga ana juaj.* [...] ]

III.3.10. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues në Sistemin e Prokurimit Publik, nisur nga kriteri i përcaktuar në dokumentat e tenderit, konstaton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për specialistë “Kimistë-Teknologë Ushqimorë” dhe “Kuzhinierë”, por në asnjë rast nuk ka paraqitur dokumentacionin për punonjës “Specialis Veteriner”. Akoma më tej, vetë bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, deklaroi se janë paraqitur disa specialistë ekuivalent, por jo specialist veteriner.

III.3.11. Sa më sipër, KPP sqaron se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë fizike dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk e ka plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.2.12 të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.3.12. K.P.P. gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kritereve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]*”.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “MB Kurti” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i është pranuar një prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij bashkimi operatorësh nuk do të ndryshojë duke mbetur i skualifikuar nga procedura në fjalë, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “SEAD-SGS” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-53685-03-05-2018, me objekt: “Blerje ushqime për Spitalin Rajonal Shkodër për vitin 2018”, me fond limit 7.009.992 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 16.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Shkodër.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k. & “MB Kurti” sh.p.k. për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “SEAD-SGS” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “SEAD-SGS” sh.p.k.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 662 Protokoli**  
**Datë 03.04.2018**

**Nr. 705 Protokoli**  
**Datë 06.04.2018**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Zv/Kryetar**  
**Leonard Gremshi**

**Anëtar**  
**Hektor Balluku**

**Anëtar**  
**Kleves Janku**

**Anëtar**  
**Odise Moçka**

